

VENDIM
Nr.526, datë 11.12.1992

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.281, DATË 1.7.1992 "PËR LIBERALIZIMIN DHE RRITJEN E ÇMIMEVE TË BLERJES NGA SHTETI TË DISA PRODUKTEVE BUJQËSORE E BLEGTORALE"

Me propozimin e Ministrisë së Financave e të Ekonomisë dhe të Ministrisë së Bujqësisë e të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pika 1 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.281, datë 1.7.1992, ndryshohet si vijon Çmimet maksimale të blerjes së grurit, të panxharsheqerit, orizit e lulediellit caktohen si vijon:

	Njësia	Çmimi
1. Gruri.....	lek/ton	4000
2. Panxharsheqeri.....	"	1800
3. Luledielli.....	"	18000
4. Oriz i pazzhveshur.....	"	24000

Pas pikës 2 shtohet pika 2/a me këtë përmbajtje:

Këto çmime do të zbatohen për prodhimin e ri të vitit të ardhshëm, duke filluar nga data 11 qershor 1993.

Pika 3 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.281, datë 1.7.1992, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi